



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 020 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 725 Nr. i faq./Br. str./No. pg 74
Data/Datum/Date 29 / 05 / 2020
RAHOVEC / ORAHOVAC

DËMET NË BUJQËSI

Raport i vlerësimit të dëmeve të
shkaktuara nga breshëri dhe vërshimet

Rahovec, maj 2020



PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	2
2.	KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE.....	2
3.	SEKTORËT E DËMTUAR	4
3.1	Spektori i Perimekulturës	4
	Tabela nr. 1 Perimekultura	5
3.2	Spektori i lavërtarisë.....	6
	Tabela nr. 2 Kultura lavërtarë	6
3.3	Spektori i vreshtarisë.....	6
	Tabela: 3 Rrushi i tryezës	7
	Tabela: 4 Rrushi i verës	7
	Tabela: 5 Tabela e përbashkët për vreshtari	8
3.4	Spektori i pemëtarisë	8
	Tabela nr. 6 Pemëtaria.....	8
4.	TABELA PËRMBLEDHËSE PËR TË GJITHË SEKTORËT.....	8
	Tabela nr. 7 Tabela e përgjithshme	8
5.	PËRFUNDIM	9

1. HYRJE

Si pasojë e të reshurave të mëdha të shiut dhe breshrit, komuna e Rahovecit është goditur në masë të madhe duke dëmtuar shumë kultura bujqësore. Ky raport do të paraqes një përshkrim të dëmeve në kulturat bujqësore, në bazë të informacioneve të raportuara nga banorët e Komunës së Rahovecit si dhe nga analiza e zyrtarëve që kanë dalë në terren.

Raporti përmban të dhëna të sakta nga vizita në terren, harta si dhe fotografi që e dëshmojnë dëmin e shkaktuar në kultura të ndryshme bujqësore që kultivohen në komunën e Rahovecit.

Këto të dhëna janë të nxjerra nga listat e përpiluara nga anëtarët e komisionit në terren gjatë vizitës në secilën parcelë që është prekur nga breshri dhe vërshimet.

2. KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE

Në bazë të vendimeve të Kryetarit të Komunës, z. Smajl Latifit, nr. 712, 713, 714 dhe 715 të datës: 21.05.2020, janë formuar komisione vlerësuese të dëmeve të shkaktuara në bujqësi nga breshri dhe reshjet e rrëmbyeshme të shiut me 19 dhe 20 maj, si dhe reshjeve të vazhdueshme të ditëve në vijim pas këtyre datave.

Me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe pëlqimit të sekretarit të përhershëm të MBPZHR-së, komisionit i është bashkangjitur dhe Nesim Morina, zyrtar për vreshtari nga departamenti i Vreshtarisë dhe Verëtarisë (DVV) në Rahovec.

Për vlerësim sa më real të dëmeve të shkaktuara, ky komision është ndarë në katër grupe për të përfshirë të gjitha zonat e prekura dhe të gjitha kulturat bujqësore në komunën e Rahovecit, në një afat sa më të shkurtër.


Komisionet vlerësuese, që nga data: 21.05.2020 kanë dalë në terren, duke mbledhur informacione dhe mbajtur shënime se në cilat zona ka pasur dëme nga breshri dhe përmbytje nga shirat e rrëmbyeshëm.

Breshri ka filluar në orët e mërkurës të datës 19.05.2020 dhe ka zgjatur mbi 30 minuta në disa zona të komunës së Rahovecit, poashtu breshri ka filluar edhe me datë: 20.05.2020 të cilat më pastaj janë shoqëruar me reshje të rrëmbyeshme duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në të gjitha kulturat bujqësore të cilat janë përfshirë nga kjo fatkeqësi natyrore.


Sipas vlerësimit të komisionit, sipërfaqet e tokave bujqësore të atakuara nga breshëri janë mbi 700 ha dhe ka përfshirë këto zona: Rahovec (zona Hamoc), Brestoc, Nagac, Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe, Zaqisht, Retijë dhe Krushë e Madhe. Poashtu breshër në sasi më të vogël ka patur edhe në zonat tjera të komunës sonë.



Dëmet më të mëdha nga breshri janë shkaktuar në zonat kadastrale si: Krushë e Madhe, Zaqishtë, Brestoc dhe Retijë, duke u shpërndarë përreth me një shkallë më të ulët, përqindja e demit të shkaktuar në këto zona ka qenë nga 20% deri në 100% në disa kultura bujqësore.




Harta 1. Breshri me datë 19.05.2020



Harta 2. Breshri me datë 20.05.2020

Përveç dëmeve nga breshri, reshjet e shiut të cilat kanë vazhduar për disa ditë rresht, kanë ndikuar që përrrenjtë e fshatrave të dalin nga shtrati i tyre dhe si rezultat i kësaj janë përmbytur shumë toka bujqësore. Për këtë, Drejtoria e Bujqësisë ka vlerësuar gjendjen në terren ku edhe janë bërë ndërhyrjet e nevojshme për të tejkaluar situatën emergjente. Fotoja e bashkangjitur paraqet njërin nga përrrenjtë në komunë të Rahovecit e cili në pamundësi për të përballuar intenzitetin e lartë të reshjeve, ka bërë që rrjedha e ujit të dalë nga shtrati dhe kështu të shkaktojë dëme të konsiderueshme.



Dëmet më të mëdha nga vërshimet kanë ndodhur në zonën kadastrale Krushë e Madhe, ku janë përmbytur mbi 150 ha të tokave bujqësore, e të cilat në këtë kohë ishin në periudhën më të mirë të vegjetacionit.



Harta nr. 3, Hapësirë e cila është vërsuar nga dalja e përroit nga shtrati në mes të fshatrave Krushë e Madhe dhe Randobravë.

3. SEKTORËT E DËMTUAR

Kushtet klimatike të mesit të muajit maj 2020, ishin të atilla që shkaktuan dëme pothuajse në të gjithë sektorët e bujqësisë në komunë të Rahovecit.

Nga breshri dhe vërshimet janë dëmtuar shumë sektorë të cilët do të grupohen në 4 grupe:

1. Sektori i perimekulturës
2. Sektori i lavërtarisë
3. Sektori i vreshtarisë, dhe
4. Sektori i pemëtarisë

3.1 Sektori i Perimekulturës

Vet fakti se Rahoveci njihet edhe si kryeqyteti i bujqësisë kjo dëshmohet edhe nga sipërfaqet e mëdha të mbjella me kultura perimtare.

Llogaritet që me perime janë të mbjellura rreth 2,200 ha, nga këto pjesën më të madhe e dominojnë sipërfaqet me specatë të llojeve të ndryshme dhe duke vazhduar me patate, shalqi, kunguj, qepë etj.

Ky sektor është ndër më të goditurit nga breshri dhe vërshimet që ndodhën në maj të këtij viti.

Nga të dhënat e grumbulluara të anëtarëve të komisionit llogaritet se nga breshri dhe vërshimet janë përfshirë 233.55 ha, ku dominon kultura e specit me 77.66 ha, e duke vazhduar me kunguj, shalqi, qepë, patate etj.

Tabela nr. 1 Perimekultura

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar	Rendiment i dëmtuar në kg	Vlera në €
1	Specia	77.66	1,832,250	549,675.00 €
2	Shalqi	24.84	1,089,810	217,962.00 €
3	Patate	25.08	717,280	179,320.00 €
4	Domate	2.05	87,300	34,920.00 €
5	Qepë	13.57	405,520	121,656.00 €
6	Lakra	11.74	581,910	87,286.50 €
7	Lulelakër	0.40	10,000	3,000.00 €
8	Kunguj	60.06	1,402,500	195,102.00 €
9	Pjepër	4.62	128,170	128,170.00 €
10	Tranguj	0.84	16,200	5,670.00 €
11	Karrota	3.59	89,750	22,437.50 €
12	Sallatë e Gjelbër	0.52	13,000	6,500.00 €
13	Dredhëza	3.45	51,750	51,750.00 €
14	Domate e Zezë	0.32	9,600	1,920.00 €
15	Spinaq	0.31	8,060	1,612.00 €
16	Presh	2.00	40,000	10,000.00 €
17	Bimë mjekuese	2.50	-	6,408.00 €
18	Fidane (Rasat)	-	-	13,600.00 €
TOTAL		233.55	6,483,100	1,636,989.00 €

Sqarim:

Ne këtë tabelë janë paraqitur sipërfaqet e dëmtuara si dhe përqindjen e produkteve në kuadër të tabelës. Kolona "Sasia në KG" është kalkuluar në atë mënyrë duke marr për bazë vlerën referente të prodhimit për ha për secilën kulturë, si në rastin konkret për specia: 30,000 kg. Për të përllogaritur vlerën është marr për bazë çmimi mesatar nga viti i kaluar (jemi bazuar në çmimin e qendrave grumbulluese që në vitin 2019 ka qenë 0.30€)

3.2 Sektori i lavërtarisë

Në sektorin e lavërtarisë ndër dëmet më të mëdha janë krijuar te dy kulturat kryesore, siç janë: gruri dhe misri.

Sa i përket grurit duhet të themi, se edhe pak ditë na ndajnë nga periudha e korrje-shirjeve, e pikërisht në këtë kohë fermerët tanë e pësuan nga fatkeqësitë natyrore.

Llogaritet që këtë vit me këto dy kultura lavërtarë, sipërfaqe të mbjella janë: grurë 2,200 ha dhe misër 1,500 ha.

Tani nga këto sipërfaqe të dëmtuara nga breshri dhe vërshimet kemi 45.48 ha me grurë dhe 104.30 ha me misër.

Tabela nr. 2 Kultura lavërtarë

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar	Rendiment i dëmtuar në kg	Vlera në €
1	Gruri	45.48	77,480	13,946.40 €
2	Misri	104.30	365,832	87,799.68 €
3	Tërshëra	0.30	1,200	300.00 €
4	Jongjë	-	200	300.00 €
TOTAL		150.08	444,512	102,346.08 €

Për grurin komisioni ka vlerësuar se janë dëmtuar rreth 45,48 ha ose shprehur në sasi në shumë prej 77,480 kg. Për grurin dëmi kap vlerë financiare afër 14,000€, kurse për misrin janë dëmtuar 104.30 ha ose 365,832 kg, e që në vlerë financiare është: 87,799 €.

Në sektorin e lavërtarisë janë dëmtuar afër 150 ha dhe se shuma totale e dëmtuar, sipas komisionit kap vlerën prej 102,346 €.

3.3 Sektori i vreshtarisë

Në nivel vendi dihet që plantacione me vreshta janë të ngritur mbi 3,200 ha, me varietete të ndryshme të rrushit. Pjesa dërmuese, ose rreth 70%, e këtyre vreshtave gjenden në komunën e Rahovecit. Sikurse çdo sektor tjetër bujqësor, që është goditur nga breshëri i datës 19 dhe 20 maj edhe sektori i vreshtarisë pësoi dëme të konsiderueshme.

Shkalla më e lartë e breshrit ka përfshirë zonën në mes të fshatit Zaqisht dhe Retijë, ku dëmet janë në masën prej 80%. Poashtu edhe pjesën e Hamocit deri në Brestoc ku shkalla e dëmit është rreth 50%.

Komisioni i formuar nga kryetari Smajl Latifi, në bashkëpunim edhe me anëtarin e emëruar nga DVV, kanë dalë në terren dhe kanë përcaktuar saktë sipërfaqen që është prekur nga breshri, më pastaj nga kadastrin e vreshtave janë nxjerr dhe përpunuar të dhënat e sakta të dëmeve të shkaktuara.

Janë bërë dy kategorizime të dëmeve në sektorin e vreshtarisë:

- Dëmet e shkaktuara në rrushin e tryezës dhe
- Dëmet e shkaktuara në rrushin e verës.

Tabela: 3 Rrushi i tryezës

Nr.	Lloji i rrushit	Sipërfaqe e dëmtuar në ha	Sasia në Kg	Vlera në €
1	Rrush i tryezës 30%	79.64	371,264	148,505.00 €
2	Rrush i tryezës 50%	7.74	62,648	25,059.00 €
3	Rrush i tryezës 70%	27.88	334,560	133,824.00 €
4	Rrush i tryezës 80%	26.10	334,080	133,632.00 €
Total		141.36	1,102,552	441,020.00 €

Analiza e vlerësimit të dëmit për kulturën e rrushit konsiston në vlerësimin e sipërfaqes e cila është dëmtuar nga breshri dhe reshjet e mëdha të shiut. Pas vlerësimit të sipërfaqes komisioni ka vlerësuar rendimentin e pritur të rrushit duke marr për bazë mesataren e prodhimit të fituar në tre vitet e fundit. Për rrushin e tryezës mesatarja është 16,000 kg/ha ndërsa për rrushin e verës 15,000 kg/ha. Poashtu edhe çmimi është bazuar nga tre vitet e fundit në tregun vendor, ku për rrush të tryezës është marr për bazë çmimi 0,40€ dhe për rrush të verës 0.27€

Konform këtyre të dhënave komisioni ka vlerësuar se janë rreth 1.1 milion kg rrush i tryezës që është dëmtuar. Kur për këtë sasi të rrushit të dëmtuar shumëzohet me çmimin njësi prej 0.40 €/kg, atëherë vijmë tek analiza se dëmet financiare për rrushin e tryezës kapin vlerën prej 441,020 €.

Tabela: 4 Rrushi i verës

Nr.	Lloji i rrushit	Sipërfaqe e dëmtuar në ha	Sasia në Kg	Vlera në €
1	Rrush i verës 30%	105.55	451,777	121,979.00 €
2	Rrush i verës 50%	58.43	472,050	127,453.00 €
3	Rrush i verës 70%	28.34	318,825	86,082.00 €
4	Rrush i verës 80%	35.16	421,920	113,918.00 €
Total		227.48	1,664,572	449,432.00 €

Analogjia e njëjtë e analizës edhe te rrushi për verë, ka rezultuar në vlerësimin e komisionit se janë dëmtuar rreth 1.6 milion kg rrush i verës, e që në vlerë financiare dëmi konsiston në shumën prej afër gjysmë milion euro.

Tabela: 5 Tabela e përbashkët për vreshtari

Nr.	Lloji i rrushit	Sipërfaqe e dëmtuar	Rendiment i dëmtuar në kg	Vlera në €
1	Rrush i tryezës	227.48	1,102,552	449,434.00 €
2	Rrushe i verës	141.36	1,664,572	441,020.00 €
TOTAL		368.84	2,767,124	890,454.00 €

Vlera e përgjithshme e dëmeve në vreshtari për të dyja llojet është rreth 900,000€

3.4 Sektori i pemëtarisë

Fatmirësisht ky sektor ka pësuar më së paku dëme pasi në zonën e goditur nga breshri janë të ngritura një numër i vogël i plantazheve.

Komisioni ka arritur të evidentoj vetëm dy lloje të pemishteve të dëmtuara, kumbulla dhe arra. Sipërfaqja totale sillet rreth 4 ha të dëmtuara nga breshri.

Tabela nr. 6 Pemëtaria

Nr.	Lloji i rrushit	Sipërfaqe e dëmtuar	Rendiment i dëmtuar në kg	Vlera në €
1	Kumbulla	2.68	28,020	9,807.00 €
2	Arra	1.52	752	1,504.80 €
TOTAL		4.2	28,772	11,311.80 €

4. TABELA PËRMBLEDHËSE PËR TË GJITHË SEKTORËT

Sqarim: Në tabelën e mëposhtme janë kategorizuar dëmet e përgjithshme në perimekulturë, lavërtari, rrushin e tryezës, rrushin e verës dhe pemëtari. Kjo tabelë tregon në mënyrë të përgjithësuar për: sipërfaqen e dëmtuar, rendimentin e pritur për secilin sektor si dhe vlerën e dëmit të shkaktuar.

Tabela nr. 7 Tabela e përgjithshme

Nr.	Kultura	Sipërfaqe e dëmtuar	Rendiment i dëmtuar në kg	Vlera në €
1	Perimekulturë	233.55	6,483,100	1,636,989.00 €
2	Lavërtari	150.08	444,512	102,346.08 €
3	Vreshtari	368.84	2,767,124	890,454.00 €
4	Pemëtari	4.20	28,772	11,311.80 €
TOTAL		756.67		2,641,100.88 €

5. PËRFUNDIM

Raporti është përgatitur me kujdes, falë një pune të mundimshme e cila i ka marrë kohë komisionit për vlerësimin e dëmeve. Komisioni ka dalë në terren ku ka parë, analizuar dhe ka bërë vlerësimin. Natyrisht, se ka pasur edhe vërejtje ndaj komisionit nga palët e dëmtuara për mënyrën, metodën dhe kriteret që ka përdorur komisioni për vlerësim.

DBPZHR ka grumbulluar fotografitë dhe videot si dëshmi që i ruan për të faktuar dëmet e mëdha.

Shkalla e gabimit në gjithë këtë proces është 5%.

Raporti i Komisionit për vlerësimin e dëmeve në bujqësi përmban edhe listën e bujqve të dëmtuar, emrat dhe mbiemrat e tyre, sipërfaqet e dëmtuara, sasinë e përlogaritur në kg. si dhe vlerën financiare të dëmit.

Rahovec

Smajl Latifi

Kryetar i Komitetit të Rahovecit

